



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK
OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	22.05.2024
Numër:	07/ zyrtarisht
Për:	Kuvendin Komunal Gjakovë
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Gjakovë, Udhëh.sekt.urb.: Mirlinda Mullahasani, inxh.dip.ark.
Përmes:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Konfirmim mbi destinimin e parcelës kadastrale

Duke iu referuar kërkesës për negociim për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale drejtuar Komunës së Gjakovës, për parcelën me numër P-70705029-00468-23 ZK Gjakovë Qytet dhe takimeve zyrtare të mbajtura për negociimin e ofertave, DUMM do të konfirmoj si në vijim - destinimin sipas dokumentit të planifikimit Hartës Zonale.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas shqyrtimit të lokacionit ka konstatuar se sipas dokumentit të planifikimit hapësinor Hartës Zonale Komunale 2024-2032, të aprovuar pranë Kuvendit Komunal me Vendimin numër Nr. 011/01-1392 të datës 31.01.2024, zona në të cilën është e përfshier parcela kadastrale numër P-70705029-00468-23 ZK Gjakovë Qytet, është e destinuar si në vijim:

- P-70705029-00468-23 – Zonë Komercale / ZK5 / (Hotel).

Në Zonat Komercale janë të përcaktuara shfrytëzimet dhe aktivitetet e lejuara të cilat janë radhitur si më poshtë:

Shfrytëzimet e lejuara

Në kuadër të ZK1, ZK2,ZK3, ZK4 dhe ZK5, shfrytëzime e lejuara janë funksionet dhe aktivitetet si në vijim:

- Tregti me shumicë, Tregti me pakicë, Afarizëm tregti - Biznese, Pomp Benzine, Tregu i gjelbërt dhe kafshëve, Shërbim i akomodimit (kampingjet, restaurantet, hotelet, motel, baret, bujtinë), Shërbime të tjera tregtare, infrastruktura rrugore si dhe infrastruktura ujësjellësit dhe ujërave të zeza, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, Infrastrukturë e telekomunikacionit.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore

Në kuadër të ZK1, ZK2,ZK3, ZK4 dhe ZK5, shfrytëzime të lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

- Shërbimet tregtare si: (tregtia me pakicë, Riparimi i automjeteve, mallrave personale dhe shtëpiake), shërbimet profesionale financiare dhe informacionit, Shërbim i komunitetit,

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nena Tereze Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390 322 452, 323 210, 320 070 Fax: +381 390 322 452

www.gjakova-komuna.org

Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ. Shërbime teknike profesionale dhe shkencore, shërbime administrative dhe mbështetëse, shërbime të sigurisë publike dhe emergjencave.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të ZK1, ZK2, ZK3, ZK4 dhe ZK5, por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

- Shërbim kulturor, Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, hapësirë e mbuluar rekreative, hapësirë e hapur rekreative, Shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbime arsimore, shërbime shëndetësore dhe shoqërore, shërbime fetare, minierat sipërfaqësore.

Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të ZK1, ZK2, ZK3, ZK4 dhe ZK5, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna ndërsa mbi 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep institucionet qendrore), Prodhim bujqësor për konsumvetjak , Mbledhje e produkteve natyrore, peshkimi, kopshtet familjare, minierat.

Bashkangjitur:

Ekstraktin nga “Harta Zonale Komunale 2024-2032” e Komunës së Gjakovës në të cilin është identifikuar pozita e parcelës dhe destinimi.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereze Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390 322 452, 323 210, 320 070 Fax: +381 390 322 452

www.gjakova-komuna.org



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



EKSTRAKT NGA HARTA ZONALE KOMUNALE 2024-2032

Zona Kadastrale: Gjakovë Qytet

Parc: Nr. P-70705029-00468-23

-  Zonë Komerciale / Hotel / ZK5
-  Zonë Rekreative - Turistike / Hapësir e gjelbërt / ZrT1
-  Zonë e Banimit / Banim Kolektiv / ZB5
-  Zonë e Transportit dhe Komunikacionit / Rrugë / ZKT1
-  Kufiri i parcelës



22.05.2024

Përpunoi: MSc. Arch. Rozafat Hoxha

